



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 67, datë 06.12.2007

**“MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË OBJEKTIT ME SIPËRFAQE MBI
200 M² TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE NË ADMINISTRIM TË
BASHKISË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "e", V.K.M. Nr.378, datë 12.08.1999 "Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", V.K.M, Nr. 162, datë 07.03.2007 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe të institucioneve shtetërore", Udhëzimit Nr.562, datë 15.08.2007, pika 1, si dhe kërkesës së ndërmarrjes, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Aseteve "Mbi miratimin në parim të dhënies me qira të objektit me sipërfaqe mbi 200 m² të pasurive të ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Keshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të tretëve, të objektit me sipërfaqe mbi 200 m² të pasurive të ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë si më poshtë:

Ndërmarrja Metalike "Tirana"

Reparti i Mekanizimeve

Sip 203 m²

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol Dervishaj

K R Y E T A R